

HERITAGE

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR HERITAGE SHPK

Në Tiranë, sot më date 27.09.2021 (dymijëenjëzetënjë) unë i nënshkruari:

- Dorian Husi, i datëlindjes 27.09.1982, lindur në Tiranë dhe banues në Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID Nr. personal I20927052Q

Me cilësinë e "Ortakut Themelues të vetëm" redaktoj këtë Akt-Themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë, iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet përkatëse, në ligjin "Për QKR" me ndryshimet përkatëse, krijoj shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar me emrin "HERITAGE" shpk.

KREU I

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi shoqërisë me përgjegjësi të Kufizuar është "HERITAGE" shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "HERITAGE" shpk është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria") e themeluar nga ortakut i vetëm i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria e fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendra Kombëtare e Biznesit në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuaragjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.

Ortakut gëzon kuotën e tij në shoqëri në përpjestim me kontributin që ka dhënë në kapital.



HÉRITAGE

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në: Rruga Myslym Shyri, pallati 6, shkalla 4, kati 5, apartamenti 47, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Shërbime të menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të pasurive të tundshme dhe të patundshme të cilëdo natyrë qofshin publike ose private. Shitja dhe blerja, dhënia dhe marrja me qera, administrimi i pasurive të tundshme dhe të patundshme pavarësisht pronësisë publik apo privat. Shoqëria mund të kryej çfarëdo veprimtarie që lidhet me pasuritë e patundshme, pasuritë e tundshme, pasuritë industriale, aktivitetet tregtare dhe financiare, menaxhimin e investimeve lidhur me fitimet shoqërive, ofrimin e kapitaleve për themelimin e shoqërive, Asistencë në drejtimin e shoqërisë dhe zgjedhjen e administratorit si dhe cilëndo veprim tregtar të kryer me qëllim ngritjen e Rezervave dhe investimit në Kapitale. Shoqëria mundet të marrë pjesë me aksione dhe/ose investime në shoqëri të tjera tregtare në fusha të njëjta dhe të ndryshme. Shërbime të zhvillimit, shpërndarjes, liçencimit dhe mirëmbajtjen e programeve software dhe produkteve të IT -së, produkteve dhe shërbimeve inovative me vlerë të lartë teknologjike. Krijimi, zhvillimi i platformave dixhitale inovative me mundësi aksesit me teknologjitë e Big Data, të realizuara dhe krijuara nga shoqëria për blerjen dhe shitjen e pronave, njësive të pasurisë së patundshme, të tokave bujqësore dhe truallit për ndërtim, për të drejtat mbi to edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në ndërmjetësim në procedurë bashkëpunimi me shoqëri/persona juridik dhe persona fizik e individë. Zhvillimi i platformave dixhitale për kryerjen e aktivitetit të lartëpërmendur dhe finalizimin dhe thjeshtëzimin e procedurave të analizës financiare. Krijimi dhe zhvillimi i aplikacioneve IT dhe dixhitale për menaxhimin e të gjithë ciklit të aktivitetit tregtar të shoqërisë për menaxhimin e pronave, dhënies me qera, dhënies me nënqera për cilëdo pronë të menaxhuar nga shoqëria. Krijimi dhe zhvillimi i aplikacioneve dhe për menaxhimin e flukseve të punës lidhur me orët dhe burimet njerëzore të lidhura me shërbimet e sektorit imobiliar të kryer nga shoqëria të përcaktuara por jo vetëm në: Aktivitet të këshillimit teknik dhe vlerësime teknike; Aktivitet të këshillimit ligjor dhe tregtar; Oferta për investime në tregun e Pasurive të Patundshme përfshirë asistencën e çdo lloji forme në sektorin e Investimeve në Ortakëri dhe pjesëmarrje në shoqëri aksionare, procedurë Bashkimi dhe blerje shoqërisht tregtare. Kryerjen e veprimeve për pasuritë e tundshme dhe të patundshme, tregtare, industriale, bankare, hipotekore, përfshirë blerjen dhe menaxhimin e pasurive të tundshme dhe të drejtave të pasurive të patundshme. Blerja, dhënia/marrja me qera e shoqërive tregtare, shoqërive me aktivitet industrial dhe shoqërive të



HERITAGE

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

profesioneve artizanale. Kryerja e veprimeve për blerjen dhe shitjen e pronave të paluajtshme ose sëbashku, të terraneve, të të drejtave mbi to; ndërtimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ndërtesave të banimit, ambjenteve tregtare ose ndonjë destinacioni tjetër urban, të ndërhyrjeve në ndërtesa, të ristrukturimit dhe rikuperimit konservativ në ndërtesat ekzistuese, të punimeve të ndërtimit në përgjithësi; ndërtimi i komplekseve rezidenciale, tregtare, industriale, sportive, turistike ose hoteleri; urbanizimi i zonave. Shërbime profesionale për manaxhimin e portaleve onlinë për mbledhjen e kapitaleve për bizneset START-UP inovative. Zhvillimi, prodhimi, blerja dhe shitja, shpërndarja dhe ofrimi i licencës, mirëmbajtja e programeve të zgjidhjeve software dhe për produktet informatike. Zhvillimi dhe administrimi i platformave Web të dedikuara për bizneset. Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të papërmendur më sipër dhe të lejuar nga ligji Shqiptar dhe Ndërkombëtar me qëllim realizimin e objektivit të lartpërmendur të aktivitetit

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria HERITAGE do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e Biznesit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqindmijë) dhe është i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100.000 lekë. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është:

- Ortaku themelues Dorian Husi, identifikuar me ID I209270052Q është zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqindmijë) lekë, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar. Kontributet do të jenë në para dhe do të derdhen në arkën/bankën e shoqërisë pas Biznesit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepërmjet:

HÉRITAGE

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për QKR". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga ortaku dhe janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç";
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

HÉRITAGE

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katertat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shperblimeve
- e) mbiqyryrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise se veprimtanise; përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.


Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të përfaqësohet ligjerisht nga:

Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Dorian Husi, identifikuar Nr. Personal I20927052Q, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Me nënshkrim:



Administratori do të ushtrojë detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje në përputhje me ligjin dhe pa kufizime në kopetencia nga data e themelimit. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratoret në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.



HÉRITAGE

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

Tagrat e perfaqesimit të administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas Biznesit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat e administratorit

Administratoret kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël;
- d) pergatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratoret janë të detyruar të thërrasin asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

- a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) Shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- c) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas Biznesit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që ka një vlerë me të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në hazzë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

H É R I T A G E

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e Biznesit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja e ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Për QKR";
- e) me vendim të gjykates;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund të drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa kohë nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kodi Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.

H É R I T A G E

Investments, Lending, Crowdfunding & Consulting

Neni 16

Dispozita Përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua dhe u mbajt në dy kopje me përmbajtje të njëjtë dhe vlera juridike të njëjta në gjuhën shqipe.

Pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku i shoqërisë tregtare, Ortaku themelues e nënshkruan në çdo faqe dhe të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU I SHOQËRISË

HERITAGE SHPK

Dorian Husi

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Dorian Husi', is written over a horizontal line. The signature is stylized and cursive.